

BASHKIA TIRANË

Drejtuar: Bashkimi i Operatorëve Ekonomik "A.N.K" shpk & "Ed Konstruksion" shpk
Adresa: Rruga e Kavajës, Pallatet Condor, Kulla 1, Hyrja e Parë, Kati i Tretë.TIRANË

Procedura e prokurimit: "Ndërtim i ri i shkollës 9 – vjeçare S.Maçi"
Përshkrim i shkurtër i kontratës: "Ndërtim i ri i shkollës 9 – vjeçare S.Maçi", duke realizuar ndërtimin e shkollës 9-vjeçare Kosova, sipas kërkesave të përcaktuara në dokumentat standarte të tenderit

Fondi limit: 233.309.164 (dyqind e tridhjetë e tremilion e treqind e nëntë mijë e njëqind e gjashtëdhjetë e katër) lekë pa TVSH
Burimi i financimit: Vënë në dispozicion në Zbatim të Vendimit Nr.84 datë 29.12.2016 për "Miratimin e programit buxhetor afat mesëm 2017-2019 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë së Tiranës për vitin 2017", konfirmuar nga prefekti i Qarkut Tiranë me shkresën nr.prot.154/2 datë 17.01.2017.

Data e zhvillimit të procedurës së prokurimit: datë 06.09.2017 , ora 11:00

Publikime të mëparshme: (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike: Buletini i Njoftimeve Publike nr.30 datë 31.07.2017

Njoftojmë se, kanë qënë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

Bashkimi i Operatoreve Ekonomik "KUPA" shpk & "LIQENI VII" sha & "NDREGJONAJ" shpk me nr. NUIS K51615512C, K1730502Ë, K31329048I
Vlera e ofertës pa TVSH = 198.032.576 (njëqind e nëntëdhjetë e tetë milion e tridhjetë e dymijë e pesëqind e shtatëdhjetë e gjashtë) lekë.

Bashkimi i Operatorëve Ekonomik "PIENVIS" shpk & "ERGI" shpk & "BE-IS" shpk, me nr. NUIS K12410001Q, K02727229P, K71412003A
Vlera e ofertës pa TVSH = 222.808.739 (dyqind e njëzetë e dy milion e tetëqind e tetë mijë e shtatëqind e tridhjetë e nëntë) lekë.

Bashkimi i Operatorëve Ekonomikë "A.N.K" shpk & "Ed Konstruksion" shpk me nr. NUIS K61625001I, J92408001N
Vlera e ofertës pa TVSH = 227.878.319,59 (dyqind e njëzetë e shtatë milion e tetëqind e shtatëdhjetë e tetë mijë e treqind e nëntëmbëdhjetë presje pesëdhjetë e nëntë) lekë.

Janë skualifikur ofertuesit e mëposhtëm:

Bashkimi i Operatoreve Ekonomik "KUPA" shpk & "LIQENI VII" sha & "NDREGJONAJ" shpk

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave konstatoi se: Komisioni i Vlerësimit të Ofertave në mbështetje të nenit 53 të Ligjit 9643, datë 20.11.2006, për "Prokurimin publik", i ndryshuar, dhe Kreut VII,

neni 66, pika 3 të VKM Nr.914, datë 29.12.2014 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), si dhe dokumentave të tenderit të miratuara, vijoi me shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertës së paraqitur nga ky Operator ekonomik, nga ku rezultoi si më poshtë:

Autoriteti kontraktor ka kërkuar në Dokumentat Standarte të Tenderit tek Kriteret e Veçanta të Kualifikimit/Kapaciteti Teknik pika 1 si më poshtë cituar:

Kapaciteti teknik:

Përsa i përket aftësisë teknike e profesionale, Operatori Ekonomik duhet të përmbushë kërkesat e mëposhtme minimale të cilat vendosen nga Autoriteti Kontraktor si më poshtë:

Përvojë e suksesshme në realizimin e të paktën:

Punë të ngjashme për një objekt të vetëm me vlerë 50% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe konkretisht: 116.654.582 (njëqind e gjashtembedhjetë milion e gjashtëqind e pesëdhjetë e kater mijë e peseqind e tetëdhjetë e dy) lekë pa TVSH, të realizuar gjatë tri viteve të fundit.

punë të ngjashme deri ne nje kufi ku vlera monetare totale e punëve të kryera e marrë së bashku gjatë tre viteve të fundit është në një vlerë sa dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet dhe konkretisht: 466.618.328 (katërqind e gjashtëdhjetë e gjashtë milion e gjashtëqind e tetëmbëdhjetë mijë e treqind e njetete e tetë) lekë pa TVSH.

Plotësimi i njerit prej dy kushteve te sipërpermdura e ben oferten te kualifikueshme.

Vlerësimi i përvojës së suksesshme të Operatorit Ekonomik do të kryhet bazuar në deklaratat e dokumentat e mëposhtme:

Për kontrata të realizuara me ente publike,operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

Deklaratën sipas shtojcës Nr. 8, shoqëruar me: Kontratë, Situacionin përfundimtar; Aktin e kolaudimit;

Për kontrata të realizuara me sektorin privat,operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm: Deklaratën sipas shtojcës Nr. 8, shoqëruar me: Kontrate; Situacionin përfundimtar; Akt kolaudimi objekti; Fatura tatimore per cdo situacion punimesh.

Pika 1/a plotësohet nga anëtarë i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim.

Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Kurse pika 1/b duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Shoqëria “NDREGJONI” shpk ka paraqitur elektronikisht për të përmbushur kriterin e mësipërm kontratat si më poshtë:

Kontrata me objekt “Rikonstruksion shkolla 9-vjeçare Fshati Arren” me vlerë të saj pa TVSH 20.053.363 (njëzetë milion e pesëdhjetë e tre mijë e treqind e gjashtëdhjetë e tre) lekë pa TVSH.

Kontrata me objekt “Rikonstruksion i objektit nr.6 ne garnizonin e forcës tokësore (Godina e ANO-s” për nevoja të komandës së doktrinës dhe stërvitjesme vlerë të saj pa TVSH 19.850.349 (nëntëmbëdhjetë milion e tetëqind e pesëdhjetë mijë e treqind e dyzetë e nëntë) lekë pa TVSH.

Nga analiza e bërë vemë re se shoqëria “NDREGJONI” shpk ka ofertuar në këtë procedurë si Bashkim operatorësh në përqindje 28%.

Autoriteti Kontraktor ka kërkuar në Kriteret e Veçanta , Kapaciteti Teknik si më sipër cituar. Në rastin e Bashkimit të Shoqërive citohet si më poshtë:

Pika 1/a plotësohet nga anëtarë i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Kurse pika 1/b duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Në përputhje të përqindjeve shoqëria “Ndregjoni” shpk për të përmbushur kushtin e mësipërm nëse do të paraqiste një kontratë të ngjashme duhet ta paraqiste jo më poshtë se vlera 32.663.283 (tridhjetë e dy milion e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e tre mijë e dyqind e tetëdhjetë e tre) lekë pa TVSH dhe nëse do të paraqiste si kontrata të ngjashme më shumë se një kontratë duhet ti paraqiste të marra së bashku në vlerën prej 130.653.132 (njëqind e tridhjetë milion e gjashtëqind e pesëdhjetë e tre mijë e njëqind e tridhjetë e një) lekë pa TVSH.

Sa më sipër shoqëria “NDREGJONI” shpk nuk plotëson asnjërin nga kushtet e mësipërme Pra sa më sipër cituar shoqëria “NDREGJONI” shpk nuk zotëron kapacitet të mjaftueshëm teknik për sa i përket Përvojës së suksesshme në realizimin e Kontratave pune të ngjashme për të realizuar kontratën për këtë objekt prokurimi duke mos përmbushur Kriteret e veçanta për kualifikim, Kapaciteti Teknik dhe profesional, pika 1/a dhe pika 1/b, cka bie në kundërshtim me pikën 1 gërma (b) të nenit 46 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin Publik” i ndryshuar ku përcaktohet se:

Operatorët ekonomik, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtëme që AK i vlerëson të nevojshme.....

b)Aftësia teknike;Operatorët ekonomik vërtetojnë se i zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike profesionale kapacitetet organizative, makineritë, paisjet dhe asetet e tjera fizike, aftësitë organizative,.reputacionin besueshmërinë, përvojën e duhur si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën.

Gjithashtu AK në Dokumentat Standarte te Tenderit në Kriteret e Veçanta ka kërkuar për realizimin e kontratës si më poshtë:

Një punësim mesatar i të paktën 130 (njëqind e tridhjetë) personave, për periudhën Qershor 2016 - Qershor 2017 të vërtetuar me;

Shoqëria “NDREGJONI” shpk në vërtetimin e paraqitur nga administrata tatimore me Nr.prot 6153/1 të datës 20.02.2017 si dhe në vërtetimin e paraqitur nga administrata tatimor me nr.prot 15834 të datës 24.08.2017 si dhe në list pagesat për periudhën Qershor 2016-Qershor 2017 rezulton të ketë një numër mesatar prej 64 punonjësish. Ndërkohë shoqëria “NDREGJONI” shpk është kualifikuar në vend të parë pranë Autoritetit Kontraktor, Bashkia Tiranë, për procedurën e prokurimit me objekt: “Rikonstruksion i Rugës Imer Ndregjoni” (kontrata me nr.prot 10100/6 lidhur më datë 11.05.2017). Data e lidhjes së kontratës 11.05.2017 dhe kohëzgjatja e punimeve 6 (gjashtë) muaj kalendarik, ku numri mesatar i punonjësve të kërkuar për realizimin e objektit “Rikonstruksion i Rugës Imer Ndregjoni” është 50 punonjës. Shoqëria “NDREGJONI” shpk aktualisht ka të angazhuar 50 punonjës në objektin “Rikonstruksion i Rugës Imer Ndregjoni” . Në objektin ”Ndërtim i ri i shkollës 9 – vjeçare S.Maçi”, shoqëria “NDREGJONI” shpk ka hyrë si bashkim operatorësh me shoqërinë “KUPA” shpk dhe “LIQENI VII” sha dhe ashtu siç edhe vërtetohet në Akt Marrëveshjen e lidhur midis tre shoqërive të mësipërme, raporti me përqindje është në këtë mënyrë: Shoqëria “KUPA” shpk ka në këtë objekt 45% , Shoqëria “NDREGJONI” shpk ka në këtë objekt 28% dhe Shoqëria “LIQENI VII” sha ka në këtë objekt 27%

Sa më sipër cituar për realizimin e punimeve në objektin "Ndërtim i ri i shkollës 9 – vjeçare S.Maçi" duhet të angazhojë 36 punonjës nga 130 punonjës të kërkuar në dokumentat standarte të tenderit. Nga faktet e paraqitur më sipër del se shoqëria "NDREGJONI" shpk ka të punësuar për periudhën Qershor 2016- Qershor 2017 një numër mesatar prej 64 punonjësish gjithashtu ka të angazhuar në objektin "Rikonstruksion i Rrugës Imer Ndregjoni" një numër prej 50 punonjësish, në këtë mënyrë shoqërisë i mbeten disponibël 14 punonjës për tu angazhuar në objektin "Ndërtim i ri i shkollës 9 – vjeçare S.Maçi" ndërkohë që në dokumentat e tenderit numri i punonjësve të kërkuar është 130 punonjës (shoqëria NDREGJONI në bazë të përqindjeve duhet të angazhojë 36 punonjës). Pra sa më sipër shoqëria NDREGJONI shpk nuk zotëron kapacitet të mjaftueshem teknik për sa i përket personelit të nevojshëm për të realizuar kontratën për këtë objekt prokurimi duke mos përmbushur Kriteret e veçanta për kualifikim, Kapaciteti Teknik dhe profesional, pika 4/i, cka bie në kundërshtim me pikën 1 gërma (b) të nenit 46 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin Publik" i ndryshuar ku përcaktohet se: Operatorët ekonomik, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtme që AK i vlerëson të nevojshme.....b) Aftësia teknike; Operatorët ekonomik vërtetojnë se i zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike profesionale kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet dhe asetet e tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin besueshmërinë, përvojën e duhur si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën.

2. Shoqëria "KUPA" shpk në vërtetimin e paraqitur nga administrata tatimore me Nr. prot 2117/1 të datës 26.01.2017 si dhe në vërtetimin e paraqitur nga administrata tatimor me nr. prot 12416/1 të datës 27.03.2017, me nr. Prot 19505/1 të datës 21.04.2017, vërtetimin me nr. Prot 28914/1 të datës 29.05.2017, me nr. prot 36028 të datës 06.07.2017, me nr. prot 38651 të datës 26.07.2017 si dhe në list pagesat për periudhën Qershor 2016- Qershor 2017 rezultojnë të ketë një numër mesatar prej 60 punonjësish. Ndërkohë shoqëria "KUPA" shpk është kualifikuar në vend të parë pranë Autoritetit Kontraktor, Bashkia Tiranë, për procedurën e prokurimit me objekt: "Ndërtim i Rrugëve Bashkim Kodra-Shkretëve-Shpëtim Zajmi-Spahi- Ali Shefqeti" (kontrata me nr. prot 729/5 lidhur më datë 07.06.2017). Data e lidhjes së kontratës 07.06.2017 dhe kohëzgjatja e punimeve 6 (gjashtë) muaj kalendarik, ku numri mesatar i punonjësve të kërkuar për realizimin e objektit "Ndërtim i Rrugëve Bashkim Kodra-Shkretëve-Shpëtim Zajmi-Spahi- Ali Shefqeti" është 60 punonjës. Shoqëria "KUPA" shpk aktualisht ka të angazhuar 36 punonjës në objektin "Ndërtim i Rrugëve Bashkim Kodra-Shkretëve-Shpëtim Zajmi-Spahi- Ali Shefqeti". Në objektin "Ndërtim i ri i shkollës 9 – vjeçare S.Maçi", shoqëria "KUPA" shpk ka hyrë si bashkim operatorësh me shoqërinë "NDREGJONI" shpk dhe "LIQENI VII" sha dhe ashtu siç edhe vërtetohet në Akt Marrëveshjen e lidhur midis tre shoqërive të mësipërme, raporti me përqindje është në këtë mënyrë: Shoqëria "KUPA" shpk ka në këtë objekt 45%, Shoqëria "NDREGJONI" shpk ka në këtë objekt 28% dhe Shoqëria "LIQENI VII" sha ka në këtë objekt 27%

Sa më sipër cituar për realizimin e punimeve në objektin "Ndërtim i ri i shkollës 9 – vjeçare S.Maçi" duhet të angazhojë 58 punonjës nga 130 punonjës të kërkuar në dokumentat standarte të tenderit. Nga faktet e paraqitur më sipër del se shoqëria "KUPA" shpk ka të punësuar për periudhën Qershor 2016- Qershor 2017 një numër mesatar prej 60 punonjësish gjithashtu ka të angazhuar në objektin "Ndërtim i Rrugëve Bashkim Kodra-Shkretëve-Shpëtim Zajmi-Spahi- Ali Shefqeti" një numër prej 36 punonjësish, në këtë mënyrë shoqërisë i mbeten disponibël 24 punonjës për tu angazhuar në objektin "Ndërtim i ri i shkollës 9 – vjeçare S.Maçi" ndërkohë që në dokumentat e tenderit numri i punonjësve të kërkuar është 130 punonjës (shoqëria "KUPA" shpk, në bazë të përqindjeve duhet të angazhojë 58 punonjës). Pra sa më sipër shoqëria "KUPA" shpk nuk zotëron

kapacitet të mjaftueshem teknik për sa i përket personelit të nevojshëm për të realizuar kontratën për këtë objekt prokurimi duke mos përmbushur Kriteret e veçanta për kualifikim, Kapaciteti Teknik dhe profesional, pika 4/i, cka bie në kundërshtim me pikën 1 gërma (b) të nenit 46 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin Publik” i ndryshuar ku përcaktohet se: Operatorët ekonomik, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtëme që AK i vlerëson të nevojshme.....b) Aftësia teknike; Operatorët ekonomik vërtetojnë se i zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike profesionale kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet dhe asetet e tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin besueshmërinë, përvojën e duhur si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën.

Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratë (shtojca 9)

| Mjetet | Sasia | Gjendja |
|---|---------|---------------------|
| Kamion vetëshkarkues (kapaciteti mbajtës minimum 5(pese) ton dhe maksimumii 10(dhjete) ton për secilin kamion) | 3 copë | Pronësi ose me qera |
| Fadrome me goma | 2 copë | Pronësi ose me qera |
| Buldozer | 1 copë | Pronësi ose me qera |
| MotoGjenerator | 1 copë | Pronësi ose me qera |
| Eskavator me goma 0.25 m3 | 2 copë | Pronësi ose me qera |
| Kamioçinë kapaciteti mbajtës për secilën kamioçinë deri në 2 ton | 3 copë | Pronësi ose me qera |
| Autobetoniere | 2 copë | Pronësi ose me qera |
| Mini eskavator | 1 copë | Pronësi ose me qera |
| Betonforma | 1500 m2 | Pronësi ose me qera |
| Matrapik | 2 cope | Pronësi ose me qera |
| Vibrator | 2 copë | Pronësi ose me qera |
| Kamion vetëshkarkues (kapaciteti mbajtës minimum 3.5 (tre pike pese) ton dhe maksimumi 5 (pese) ton per secilin kamion) | 2 cope | Pronësi ose me qera |
| Autopompe betoni | 1 copë | Pronësi ose me qera |
| Depozitë uji (5000) | 1 copë | Pronësi ose me qera |
| Skela metalike (forme H) të kompletuara me parapet mbrojtës, shkallë me rretë mbrojtëse për punime në fasadë) | 1500 m2 | Pronësi ose me qera |
| Prerëse Asfalti | 2 cope | Pronësi ose me qera |
| Aparat Saldimi | 2 copë | Pronësi ose me qera |
| Autobot uji | 1 copë | Pronësi ose me qera |

| | | |
|--|--------|---------------------|
| Fabrike prodhim betoni | 1 copë | Pronësi ose me qera |
| Kamion vetëshkarkues (kapaciteti mbajtës minimum 12 (dymbëdhjete) ton dhe maksimumi 20 (njetete) ton per secilin kamion) | 2 copë | Pronësi ose me qera |

| | | |
|---------------------------------------|--------|---------------------|
| Rul me kompresor per ngjeshje asfalti | 1 cope | Pronësi ose me qera |
| Rul me Vibrim | 1 copë | Pronësi ose me qera |

Të paraqiten mjete dhe pajisje të mbrojtjes në punë të punëtorëve, personelit si më poshtë:

Kokore minimumi 30 copë

Rripa lidhës sigurimi për punime në lartësi minimumi 3 copë

Fikëse zjarri të lëvizshme me kapacitet 5-7 litra secila minimumi 3 copë

Prozhektorë ndriçimi natën minimumi 4 copë

Komplet i ndimës së shpejtë minimumi 5 copë

Tabela paralajmëruese për sigurinë në objekt minimumi 15 copë

Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), plus certifikaten e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit (te vlefshme), dhe për mjetet e siguruar me qera, dokumenti që verteton regjistrimin e tij plus certifikaten e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit, (te vlefshme) duhet të shoqerohet me kontratën përkatëse të qerave/furnizimit, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi. Në rastin e mjeteve të tjera duhet të jenë aktet e çdoganimit ose faturat tatimore të blerjes.

Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publike duhet të paraqiten dokumentat që vërtetojnë pronësinë e tyre.

Për mjetet e marra me qera të të paraqitet kontrata përkatëse noteriale e qirasë ku të specifikohet objekti i kontratës dhe afati i saj.

Për fabriken e prodhimit të betonit, në rast se është në pronësi duhet të paraqitet akti i pronësisë i shoqeruar me leje mjedisore leshuar nga QKL. Në rast se operatori ekonomik ka kontratë qeraje duhet të paraqitet akti i pronësisë së qiradhsit shoqeruar me lejen mjedisore leshuar nga QKL. Kontrata e qerave duhet të jetë e noterizuar, ku të specifikohet objekti i kontratës dhe afati i saj. Operatori ekonomik duhet të paraqesë foto për secilin mjet të deklaruar ku të jetë e dukshme dhe targa e mjetit.

Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës mjetet e pajisjet teknike të deklaruara sipas shtojcës Nr. 9. (Deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese).

Makinëritë e mësipërme nuk janë të angazhuara në kontrata të tjera dhe nuk janë të deklaruara në procedurat të shpallura fitues nga autoriteti kontraktor, Bashkia Tirane. (Deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese ku të deklarohet dhe vendndodhja e mjeteve në pronësi ose me qera me qëllim verifikimi).

(opsion) Do të organizohet një vizitë në kantier deri në datë 21.08.2017 në mënyrë të tillë që Operatorët Ekonomikë të mund të familiarizohen me kushtet lokale. Operatori i interesuar Ekonomik duhet të konfirmojë paraprakisht me shkrim synimin e tij për të marrë pjesë në këtë

vizitë. Gjatë vizitës do t'u jepen informacione shtesë e shpjegime. Të gjitha kostot e Operatorëve Ekonomikë që lidhen me vizitën në kantier duhet të mbulohen nga vetë ata. Pa paragjykuar sa më sipër, dhe me kostot e risqet e veta, një operator ekonomik mund t'a vizitojë në çdo kohë vendndodhjen e kantierit, nëse një gjë e tillë është e mundur.

Për të organizuar një vizitë në kantier, ju lutem drejtoni nje shkresë prane Drejtorise se Prokurimit Bashkia Tiranë.

Bashkimi i Operatorëve ekonomik të mësipërm ka deklaruar në shtojcën 9 mjete të cilat janë siguruar nëpërmjet kontratave të qirave si më poshtë”

Kontrata e Qerasë me nr.286 rep dhe 78/1 kol për mjetet kamion deri në 10 ton kapacitet mbajtës (3 mjete)me palë qiradhënëse “Silbora” shpk dhe palë qeramarrëse Kupa shpk e lidhur më datë 5.09.2017 dhe me afat 1 vjekar pra deri një vit gjithashtu nuk citohet në kontratë e drejta e rinovimit të kontratës.

Kontrata e Qerasë me nr.19 rep dhe 13 kol për mjetet Autobetoniere , autopompë, saldatriçe dhe prerëse asfalti me palë qiradhënëse “Korabi 2007” shpk dhe palë qeramarrëse “Kupa” shpk e lidhur më datë 26.01.2017 dhe me afat 1 vjekar pra deri një vit gjithashtu nuk citohet në kontratë e drejta e rinovimit të kontratës.

Autoriteti Kontraktor në përmbushjen e kriterit të deklarimit të mjeteve ka kërkuar paraqitjen e dokumentave si në rastin kur mjetet janë në pronësi dhe në rastin kur mjetet janë siguruar nëpërmjet qerasë dhe në rastin kur mjetet janë siguruar nëpërmjet qerasë operatori ekonomik duhet të sigurohet që afati i qerasë të jetë i vlefshëm për të gjithë periudhën e realizimit te kontrates objekt i ketij prokurimi

Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), plus certifikaten e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit (te vlefshme), dhe per mjetet e siguruara me qera, dokumenti qe verteton regjistrimin e tij plus certifikaten e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit,(te vlefshme) duhet te shoqerohet me kontraten perkatese te qerases/furnizimit, e vlefshme per te gjithë periudhen e realizimit te kontrates objekt i ketij prokurimi. Në rastin e mjeteve te tjera duhet te jene aktet e çdoganimit ose faturat tatimore te blerjes.

Afati i realizimit të objektit të këtij prokurimi është 18 (tetëmbëdhjetë) muaj, sa më sipër kontratat e qerasë të mësipërme janë të pavlefshme për rrjedhojë Bashkimi i Operatorëve Ekonomikë nuk ka paraqitur për realizimin me sukses të kontratës objekt prokurimi tre Kamion vetëshkarkues (kapaciteti mbajtës minimum 5(pese) ton dhe maksimumii 10 (dhjete) ton për secilin kamion)

Pra sa më sipër cituar dokumentacioni i paraqitur nga Bashkimi i Operatorëve Ekonomik lidhur me shtojcën 9 , me pikën 11 është i paplotë , për rrjedhojë i pavlefshëm

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të Nenit 53 pika 5, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për Prokurimin publik” (i ndryshuar) dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu VII,Neni 66 pika 3, e shpall të pavlefshme këtë ofertë pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

Bashkimi i Operatorëve Ekonomik “PIENVIS” shpk & “ERGI” shpk & “BE-IS” shpk
Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave konstatoi se: Komisioni i Vlerësimit të Ofertave në mbështetje të nenit 53 të Ligjit 9643, datë 20.11.2006, për “Prokurimin publik”, i ndryshuar, dhe Kreut VII, neni 66, pika 3 të VKM Nr.914, datë 29.12.2014 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik”,

i ndryshuar si dhe dokumentave të tenderit të miratuara, vijoi me shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertës së paraqitur nga ky Bashkim Operatorësh Ekonomik, nga ku rezultoi si më poshtë:

AK në Dokumentat Standarte te Tenderit në Kriteret e Veçanta ka kërkuar për realizimin e kontratës si më poshtë:

Një punësim mesatar i të paktën 130 (njëqind e tridhjetë) personave, për periudhën Qershor 2016 - Qershor 2017 të vërtetuar me;

Shoqëria “BE-IS” shpk në vërtetimin e paraqitur nga administrata tatimore me Nr.prot 1987 prot të datës 15.08.2017 si dhe në vërtetimin e paraqitur nga administrata tatimor për muajt janar-qershor 2017 si dhe në list pagesat për periudhën Qershor 2016-Qershor 2017 rezultoi të ketë një numër mesatar prej 117 punonjësish. Ndërkohë shoqëria “BE-IS” shpk është kualifikuar në vend të parë pranë Autoritetit Kontraktor, Bashkia Tiranë, për procedurën e prokurimit me objekt: “Rikualifikim urban i bllokut nr.1 laprake, kufizuar nga rruga Don Bosko-Shina e Trenit Finlanto-Turhan Pashë Përmeti-Ibrahim Pashë Bushatlliu-Lord bajron- Riza Cuka-Learton Vathi-Pandi Dardha-Dritan Hoxha” (kontrata lidhur më datë 04.10.2016). Data e lidhjes së kontratës 04.10.2016 dhe kohëzgjatja e punimeve 18 (tetëmbëdhjetë) muaj kalendarik, ku numri mesatar i punonjësve të kërkuar për realizimin e objektit të mësipërm është 200 punonjës dhe shoqëria BE-IS ka të angashuar 60 punonjës, është kualifikuar në vend të parë pranë Autoritetit Kontraktor, Bashkia Tiranë, për procedurën e prokurimit me objekt: “Rikonstruksion i rrugës së Zallit” (kontrata lidhur më datë 11.11.2016). Data e lidhjes së kontratës 11.11.2016 dhe kohëzgjatja e punimeve 10 (dhjetë) muaj kalendarik, ku numri mesatar i punonjësve të kërkuar për realizimin e objektit të mësipërm është 90 punonjës dhe shoqëria BE-IS ka të angashuar për këtë objekt 23 punonjës, është kualifikuar gjithashtu në vend të parë pranë Autoritetit Kontraktor, Bashkia Tiranë, për procedurën e prokurimit me objekt: “Rikonstruksion i shkollës 9-vjecare “Dora Distria” (kontrata lidhur më datë 06.09.2017). Data e lidhjes së kontratës 06.09.2017 dhe kohëzgjatja e punimeve 8 (tetë) muaj kalendarik, ku numri mesatar i punonjësve të kërkuar për realizimin e objektit të mësipërm është 90 punonjës dhe shoqëria BE-IS ka të angashuar 30 punonjës. Gjithashtu më datë 17.08.2017 pranë AK, Bashkia Tiranë ka mbërritur kërkesa për shtesë kontrate me objekt “Rruga për në Fshatin Kasallë (Degëzimi nga Çerkezi në Cinam) rreth 2 km” me afat kohor 30 ditë, operatori ekonomik BE-IS shpk ka të angazhuar në këtë kontratë 24 punonjës.

Shoqëria “BE-IS” shpk, aktualisht ka të angazhuar 137 punonjës në objektet e sipërcituar. Në objektin “Ndërtim i ri i shkollës 9 – vjeçare S.Maçi”, shoqëria “BE-IS” shpk ka hyrë si Bashkim Operatorësh me shoqërinë “PIENVIS” shpk dhe “ERGI” shpk dhe ashtu siç edhe vërtetohet në Akt Marrëveshjen e lidhur midis tre shoqërive të mësipërme, raporti me përqindje është në këtë mënyrë: Shoqëria “PIENVIS” shpk ka në këtë objekt 58,99% Shoqëria “ERGI” shpk ka në këtë objekt 38.79% dhe Shoqëria “BE-IS” shpk ka në këtë objekt 2.21%

Sa më sipër cituar për realizimin e punimeve në objektin “Ndërtim i ri i shkollës 9 – vjeçare S.Maçi” duhet të angazhojë 3 punonjës nga 130 punonjës të kërkuar në dokumentat standarte të tenderit. Nga faktet e paraqitur më sipër del se shoqëria “BE-IS” shpk ka të punësuar për periudhën Qershor 2016- Qershor 2017 një numër mesatar prej 117 punonjësish gjithashtu ka të angazhuar në objektet e mësipërme një numër prej 137 punonjësish, në këtë mënyrë shoqërisë nuk i mbetet disponibël asnjë punonjës për tu angazhuar në objektin “Ndërtim i ri i shkollës 9 – vjeçare S.Maçi” ndërkohë që në dokumentat e tenderit numri i punonjësve të kërkuar është 130 punonjës (shoqëria “BE-IS” shpk në bazë të përqindjeve duhet të angazhojë 3 punonjës). Pra sa më sipër shoqëria “BE-

IS” shpk nuk zotëron kapacitet të mjaftueshem teknik për sa i përket personelit të nevojshëm për të realizuar kontratën për këtë objekt prokurimi duke mos përmbushur Kriteret e veçanta për kualifikim, Kapaciteti Teknik dhe profesional, pika 4/i, cka bie në kundërshtim me pikën 1 gërma (b) të nenit 46 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin Publik” i ndryshuar ku përcaktohet se: Operatorët ekonomik, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtëme që AK i vlerëson të nevojshme.....b) Aftësia teknike; Operatorët ekonomik vërtetojnë se i zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike profesionale kapacitetet organizative, makineritë, paisjet dhe asetet e tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin besueshmërinë, përvojën e duhur si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën.

Autoriteti kontraktor ka kërkuar në Dokumentat Standarte të Tenderit tek Kriteret e Veçanta të Kualifikimit/Kapaciteti Teknik pika 1 si më poshtë cituar:

Kapaciteti teknik:

Përsa i përket aftësisë teknike e profesionale, Operatori Ekonomik duhet të përmbushë kërkesat e mëposhtme minimale të cilat vendosen nga Autoriteti Kontraktor si më poshtë:

Përvojë e suksesshme në realizimin e të paktën:

Punë të ngjashme për një objekt të vetëm me vlerë 50% e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe konkretisht: 116.654.582 (njëqind e gjashtembedhjetë milion e gjashtëqind e pesëdhjetë e kater mijë e peseqind e tetëdhjetë e dy) lekë pa TVSH, të realizuar gjatë tri viteve të fundit.

punë të ngjashme deri ne nje kufi ku vlere monetare totale e punëve të kryera e marrë së bashku gjatë tre viteve të fundit është në një vlerë sa dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet dhe konkretisht: 466.618.328 (katërqind e gjashtëdhjetë e gjashtë milion e gjashtëqind e tetëmbëdhjetë mijë e treqind e njetë e tetë) lekë pa TVSH.

Plotesimi i njerit prej dy kushteve te siperpermendura e ben oferten te kualifikueshme.

Vlerësimi i përvojës së suksesshme të Operatorit Ekonomik do të kryhet bazuar në deklaratat e dokumentat e mëposhtme:

Për kontrata të realizuara me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm: Deklaratën sipas shtojcës Nr. 8, shoqëruar me: Kontratë, Situacionin përfundimtar; Aktin e kolaudimit;

Për kontrata të realizuara me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm: Deklaratën sipas shtojcës Nr. 8, shoqëruar me: Kontrate; Situacionin përfundimtar; Akt kolaudimi objekti; Fatura tatimore per cdo situacion punimesh.

Pika 1/a plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim.

Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Kurse pika 1/b duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Shoqëria Piennis shpk ka paraqitur elektronikisht për të përmbushur kriterin e mësipërm kontratat si më poshtë:

1- Kontrata me nr. Prot 4347 Rep dhe 1155 kol e datës 31.08.2011 me objekt “Godinë Banimi dhe Shërbimi shtate-nente kate mbi toke dhe nje kat parkim nentoke” me vlerë të saj pa TVSH 122.706.714 (njëqind e njëzetë e dy milion e shtatëqind e gjashtë mijë e shtatëqind e katërmëdhjetë) lekë.

Nga analiza e bërë vemë re se shoqëria “Pienvis” shpk ka paraqitur për të vërtetuar përvojën e suksesshme në punë si kontratë të ngjashme , kontratën e mësipërme të lidhur me sektor privat për të cilën ka paraqitur kontratën, situacionin perfundimtar, aktin e kolaudimit.

Per kontraten e ngjashme të mësipërme Operatori Ekonomik ”Pienvis” nuk ka paraqitur Fatura tatimore per cdo situacion punimesh si dhe Deklaratën sipas shtojcës Nr. 8 të kërkuara këto në dokumentat standarte te tenderit ne kriteret e vecanta te kualifikimit /kapaciteti teknik.

Pra sa më sipër cituar shoqëria “PIENVIS” shpk nuk zotëron kapacitet të mjaftueshëm teknik për sa i përket Përvojës së suksesshme në realizimin e Kontratave pune të ngjashme për të realizuar kontratën për këtë objekt prokurimi duke mos përmbushur Kriteret e veçanta për kualifikim, Kapaciteti Teknik dhe profesional, pika 1/a dhe pika 1/b, cka bie në kundërshtim me pikën 1 gërma (b) të nenit 46 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin Publik” i ndryshuar ku përcaktohet se:

Operatorët ekonomik, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtëme që AK i vlerëson të nevojshme.....

Aftësia teknike; Operatorët ekonomik vërtetojnë se i zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike profesionale kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet dhe asetet e tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin besueshmërinë, përvojën e duhur si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën.

Në dokumentat standarte të tenderit tek Kriteret e Veçanta të Kualifikimit/Kapaciteti Teknik në pikën 11 citohet:

Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratë (shtojca 9)

| | | |
|---|---------|---------------------|
| Kamion vetëshkarkues (kapaciteti mbajtës minimum 5(pese) ton dhe maksimumii 10(dhjete) ton për secilin kamion) | 3 copë | Pronësi ose me qera |
| Fadrome me goma | 2 copë | Pronësi ose me qera |
| Buldozer | 1 copë | Pronësi ose me qera |
| MotoGjenerator | 1 copë | Pronësi ose me qera |
| Eskavator me goma 0.25 m3 | 2 copë | Pronësi ose me qera |
| Kamioçinë kapaciteti mbajtës për secilën kamionçinë deri në 2 ton | 3 copë | Pronësi ose me qera |
| Autobetoniere | 2 copë | Pronësi ose me qera |
| Mini eskavator | 1 copë | Pronësi ose me qera |
| Betonforma | 1500 m2 | Pronësi ose me qera |
| Matrapik | 2 cope | Pronësi ose me qera |
| Vibrator | 2 copë | Pronësi ose me qera |
| Kamion vetëshkarkues (kapaciteti mbajtës minimum 3.5 (tre pike pese) ton dhe maksimumi 5 (pese) ton per secilin kamion) | 2 cope | Pronësi ose me qera |
| Autopompe betoni | 1 copë | Pronësi ose me qera |
| Depozitë uji (5000) | 1 copë | Pronësi ose me qera |
| Skela metalike (forme H) të kompletuara me parapet mbrojtës, shkallë me rrjetë mbrojtëse | 1500 m2 | Pronësi ose me qera |

| | | |
|--|--------|---------------------|
| për punime në fasadë) | | |
| Prerëse Asfalti | 2 cope | Pronësi ose me qera |
| Aparat Saldimi | 2 copë | Pronësi ose me qera |
| Autobot uji | 1 copë | Pronësi ose me qera |
| Fabrike prodhim betoni | 1 copë | Pronësi ose me qera |
| Kamion vetëshkarkues (kapaciteti mbajtës minimum 12 (dymbëdhjete) ton dhe maksimumi 20 (njetete) ton per secilin kamion) | 2 copë | Pronësi ose me qera |

| | | |
|---------------------------------------|--------|---------------------|
| Rul me kompresor per ngjeshje asfalti | 1 cope | Pronësi ose me qera |
| Rul me Vibrim | 1 copë | Pronësi ose me qera |

Të paraqiten mjete dhe pajisje të mbrojtjes në punë të punëtorëve, personelit si më poshtë:

Kokore minimumi 30 copë

Rripa lidhës sigurimi për punime në lartësi minimumi 3 copë

Fikëse zjarri të lëvizshme me kapacitet 5-7 litra secila minimumi 3 copë

Prozhektorë ndriçimi natën minimumi 4 copë

Komplet i ndimës së shpejtë minimumi 5 copë

Tabela paralajmëruese për sigurinë në objekt minimumi 15 copë

Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), plus certifikaten e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit (te vlefshme), dhe për mjetet e siguruar me qera, dokumenti që verteton regjistrimin e tij plus certifikaten e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit, (te vlefshme) duhet të shoqerohet me kontratën perkatese të qerases/furnizimit, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi. Në rastin e mjeteve të tjera duhet të jenë aktet e çdoganimit ose faturat tatimore të blerjes.

Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publike duhet të paraqiten dokumentat që vërtetojnë pronësinë e tyre.

Për mjetet e marra me qera të të paraqitet kontrata përkatëse noteriale e qirasë ku të specifikohet objekti i kontratës dhe afati i saj.

Për fabriken e prodhimit të betonit, në rast se është në pronësi duhet të paraqitet akti i pronësisë i shoqeruar me leje mjedisore leshuar nga QKL. Në rast se operatori ekonomik ka kontratë qeraje duhet të paraqitet akti i pronësisë së qiradhensit shoqeruar me lejen mjedisore leshuar nga QKL. Kontrata e qerases duhet të jetë e noterizuar, ku të specifikohet objekti i kontratës dhe afati i saj. Operatori ekonomik duhet të paraqesë foto për secilin mjet të deklaruar ku të jetë e dukshme dhe targa e mjetit.

Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës mjetet e pajisjet teknike të deklaruara sipas shtojcës Nr. 9. (Deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese).

Makinëritë e mësipërme nuk janë të angazhuara në kontratë të tjera dhe nuk janë të deklaruara në procedurat të shpallura fitues nga autoriteti kontraktor, Bashkia Tirane. (Deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese ku të deklarohet dhe vendndodhja e mjeteve në pronësi ose me qera me qëllim verifikimi).

(opsion) Do të organizohet një vizitë në kantier deri në date 21.08.2017 në mënyrë të tillë që Operatorët Ekonomikë të mund të familiarizohen me kushtet lokale. Operatori i interesuar Ekonomik duhet të konfirmojë paraprakisht me shkrim synimin e tij për të marrë pjesë në këtë vizitë. Gjatë vizitës do t'u jepen informacione shtesë e shpjegime. Të gjitha kostot e Operatorëve Ekonomikë që lidhen me vizitën në kantier duhet të mbulohen nga vetë ata. Pa paragjykuar sa më sipër, dhe me kostot e risqet e veta, një operator ekonomik mund t'a vizitojë në çdo kohë vendndodhjen e kantierit, nëse një gjë e tillë është e mundur.

Për të organizuar një vizitë në kantier, ju lutem drejtoni një shkresë prane Drejtorise se Prokurimit Bashkia Tiranë.

Bashkimi i Operatorëve Ekonomik "Pienvis" shpk & "Ergi" shpk & "BE-IS" shpk kanë deklaruar në shtojcën 9 eskavator me goma në pronësi për njërin eskavator ka paraqitur si dokumentacion plotësues fat zhdoganore 36200 të datës 23.05.2004 dhe për eskavatorin tjetër ka paraqitur si dokumentacion plotësues faturen zhdoganore me nr 17037 dt 10.03.2009. Për të dy eskavatorë është paraqitur si dokumentacion shoqërues fatura doganore . Gjithashtu janë deklaruar në shtojcën nr.9 të paraqitur nga Operatori Ekonomik "Pienvis" shpk dy mjete te deklaruar si mini eskavator te siguruara me kontraten e qerese me nr. 2117 rep dhe nr 778 kol te dates 23.05.2017 per te cilat ka paraqitur vetem fature zhdoganore.

Për mjetet e mësipërme nuk janë paraqitur çertifikata e kontrollit teknik dhe siguracioni i mjetit, si dhe leja e qarkullimit rrugor mosplotësimi i këtij kushti bie në kundërshtim me "Kriteret e veçanta për kaulifikim", kapaciteti Teknik pika 11, gërma (a) ku citohet:

Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (lejë qarkullimi), plus çertifikatën e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit (të vlefshme), dhe për mjetet e siguruara me qera, dokumenti që vërteton regjistrimin e tij plus çertifikatën e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit, (të vlefshme) duhet të shoqërohet me kontratën përkatëse të qerasë/furnizimit, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi

Pra sa më sipër cituar eskavatorët me goma nuk ka lejën e qarkullimit, Çertifikatën e kontrollit teknik dhe siguracion mjeti.

Pra sa më sipër cituar dokumentacioni i paraqitur nga Bashkimi i Operatorëve Ekonomik lidhur me shtojcën 9 , me pikën 11 është i paplotë , për rrjedhojë i pavlefshëm

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të Nenit 53 pika 5, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006, "Për Prokurimin publik" (i ndryshuar) dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", Kreu VII, Neni 66 pika 3, e shpall të pavlefshme këtë ofertë pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

Është kualifikuar si ofertë e suksesshme, ky ofertues :

Oferta e paraqitur nga Bashkimi i Operatorëve Ekonomikë "A.N.K" shpk & "Ed Konstruksion" shpk, kualifikohet në vend të parë.

Çmimi total i ofertës pa tvsh = 227.878.319,59 (dyqind e njëzetë e shtatë milion e tetëqind e shtatëdhjetë e tetë mijë e treqind e nëntëmbëdhjetë presje pesëdhjetë e nëntë) lekë.

Çmimi total i ofertës me tvsh = 273.453.983,50 (dyqind e shtatëdhjetë e tre milion e katërqind e pesëdhjetë e tre mijë e nëntëqind e tetëdhjetë e tre presje pesëdhjetë) lekë.

Afati kohor për kryerjen e punimeve është brenda 18 (tetëmbëdhjetë) muajve kalendarike duke nisur nga dita e lidhjes së kontratës.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 07.09.2017

Gjatë afatit ligjor për pritjen e ankesave nga shoqëritë pjesëmarrëse në tender në mbështetje të Nenit 63 pika 2 dhe 3 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) si dhe në bazë të Kreut X, Neni 78 të VKM-së Nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), pranë Autoritetit Kontraktor, Bashkia Tiranë, nuk është paraqitur asnjë ankesë

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë se Bashkimi i Operatorëve Ekonomikë “A.N.K” shpk & “Ed Konstruksion” shpk”, me adresë: Adresa: Tiranë, Rruga e Kavajës, Pallatet Condor, Kulla 1, Hyrja e parë, kati i tretë, se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme pa TVSH 227.878.319,59 (dyqind e njëzetë e shtatë milion e tetëqind e shtatëdhjetë e tetë mijë e treqind e nëntëmbëdhjetë presje pesëdhjetë e nëntë) lekë, është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Bashkisë së Tiranës, Shëtitörja “Dëshmorët e Kombit”, nr.1, 1001, Tiranë, Sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga dita e marrjes së këtij njoftimi.